



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/13  
Datë: 18.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 41 të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, të nenit 2 të Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin e Kufirit Shtetëror, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 18 mars 2020 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e Qendrës së Studentëve në Prishtinë si hapësirë karantine**

1. Qendra e Studentëve në Prishtinë caktohet si Hapësirë Karantine.
2. Personat për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje nga Corona Virus COVID-19 futen në karantinë.
3. Qendra e Studentëve në Prishtinë, kalon në menaxhim të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Shëndetësisë, deri në pushimin e gjendjes emergjente të shpallur nga Qeveria e Kosovës me Vendimin Nr. 01/11, të datës 15 mars 2020.
4. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe institucionet tjera relevante të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë